

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 3032 Prot.

Tiranë, më 01.07.2020

Lënda Njoftim mbi përfundimin e detyrimit të qëndrimit në detyrë si gjyqtar i Gjykatës së Lartë dhe ftesë për të shprehur qëndrimin në lidhje me ushtrimin e të drejtës për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli.

Zotit ARDIAN DVORANI

GJYKATËS SË LARTË

TIRANË

I nderuar z. Dvorani

Sikurse jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor shqyrtoi çështjen e vazhdimit të qëndrimit tuaj në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë sipas përcaktimit të nenit 136, paragrafi 5, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pas emërimit dhe fillimit të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit të kësaj Gjykate, më datë 13.03.2020, të z.Sokol Sadushaj, z.Ervin Pupe dhe z.Illir Panda.

Ndërsa vendi ynë, prej datës 09.03.2020, u përfshi nën masat kundër përhapjes së Covid-19, në respektim të të cilave, më datë 12.03.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi të pezullojë kryerjen e veprimtarisë së vetë në ambientet e selisë së tij dhe realizimin nga distanca të punëve për të gjithë strukturën e tij. Ndërkohë, më datë 10.03.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor pezulloi veprimtarinë gjyqësore dhe shërbimet në të gjitha gjykatat e vendit.

Pikërisht gjatë kësaj periudhe, konkretisht më datë 15.04.2020, çështja e vazhdimit të qëndrimit tuaj në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë u soll në vëmendje të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga Presidenti i Republikës, i cili, më herët, në përputhje me kompetencën e parashikuar në paragrafin 1, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, mbi propozimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 11.03.2020, kishte emëruar në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, z.Sokol Sadushaj, z.Ervin Pupe dhe z.Illir Panda.

Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se emërimi dhe fillimi i ushtrimit të detyrës nga tre gjyqtarët e rinj të Gjykatës së Lartë, nisur nga procedurat e ndjekura prej tij për ngritjen në detyrë në këtë Gjykatë, nga radhët e juristëve të spikatur, krijonte një situatë në raport me vazhdimin e qëndrimit tuaj në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, ndërsa ju jeni emëruar nga radhët e juristëve të spikatur, ndërkohë që mandati juaj ka mbaruar më datë 24.02.2014, por që qëndronit në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, sipas paragrafit 5, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Pikërisht kjo situatë, ndërsa lidhej drejtpërdrejtë me

mbarëvajtjen e Gjykatës së Lartë, pra të organit më të lartë të pushtetit gjyqësor, por edhe me karrierën tuaj gjyqësore, meritonte të trajtohej.

Për situatën që krijohet nga emërimi dhe fillimi i detyrës së një gjyqtari të ri në Gjykatën e Lartë në raport me gjyqtarin e kësaj Gjykate që qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, por edhe në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk ka ndonjë dispozitë që rregullon atë, kjo sa i përket dorëzimit të detyrës nga gjyqtari në largim dhe/ose përcaktimin në mënyrë të shprehur të një organi publik mbikëqyrës për këtë proces.

Pavarësisht kësaj, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton Këshillin e Lartë Gjyqësor si organin përgjegjës për sigurimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor (neni 147, paragrafi 1). Po ashtu, Kushtetuta përcakton edhe funksionet e Këshillit (neni 147/a i Kushtetutës), të cilat zërthehen më tej në Ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, referuar të cilëve Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron çdo funksion në lidhje me statusin dhe, në veçanti, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve të të gjitha niveleve, me përjashtim të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Thënë sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përgjegjësinë e sigurimit të pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes edhe të Gjykatës së Lartë, si dhe për zhvillimin e karrierës edhe të gjyqtarëve të kësaj Gjykate.

Pikërisht nën këtë përgjegjësi dhe funksion kushtetutues, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se është në kompetencën e tij trajtimi i çdo situatë në lidhje me pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, përfshirë dhe të Gjykatës së Lartë, sikundër edhe me zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve edhe të kësaj Gjykate, duke patur ai juridiksion të plotë për çështje të kësaj natyre.

Mbi këtë bazë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi vuri në diskutim, duke marrë edhe qëndrimin tuaj, arriti në përfundimin se, pas emërimit dhe fillimit të ushtrimit të detyrës të tre gjyqtarëve të rinj të Gjykatës së Lartë, për ju ka mbaruar detyrimi kushtetues për të qëndruar në detyrën e gjyqtarit në këtë Gjykatë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbajti në konsideratë për këtë ngjarjet e ndodhura deri më sot dhe, sigurisht, edhe parimet e vazhdimësisë dhe funksionalitetit, sikurse dhe të pavarësisë e paanësisë së gjykatës, të cilat, referuar dokumenteve ndërkombëtare bazë për gjyqësorin¹, janë me rëndësi primare për ekzistencën dhe funksionimin e saj, e në veçanti për legjitimitetin e gjykatës.

Sipas dokumentacionit të administruar, rezulton se ju jeni emëruar në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, me Dekretin nr. 4481, datë 17.02.2005, të Presidentit të Republikës, ndërsa Kuvendi i Shqipërisë ka dhënë pëlqimin për këtë emërim me Vendimin nr. 176, datë 24.02.2005. Mandati juaj kushtetues 9-vjeçar si gjyqtar i Gjykatës së Lartë ka mbaruar në mënyrë normale, pra mbas kalimit të 9 viteve, pikërisht më datë 24.02.2014. Në përputhje me ligjin e kohës, nenin 4 të Ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

¹Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); Parimet Bazë për Pavarësinë e Gjyqësorit miratuar nga Asambleja e OKB-së; Rekomandimi për Pavarësinë, Eficientën dhe rolin e gjyqtarëve miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës; Karta Universale e Gjyqtarit etj.

Kryetari i Gjykatës së Lartë, më datë 16.01.2014, ka njoftuar Presidentin e Republikës për mbarimin e mandatit tuaj. Për vakancën e krijuar në këtë rast, Presidenti i Republikës ka filluar procedurën e emërimit të pasardhësit tuaj, duke nxjerrë dhe dekretin e emërimit². Kjo procedurë nuk është finalizuar me emërimin e gjyqtarit të ri të Gjykatës së Lartë, pasi Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin nr. 35, datë 22.05.2014, nuk dha pëlqimin për emërim e gjyqtarit të dekretuar nga Presidenti i Republikës.

Mbas kësaj nuk ka patur procedurë tjetër emërimi derisa, pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, ky Këshill filloi, më datë 09.07.2019, procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, për tre pozicione të lira (në fushat e të drejtës administrative, civile dhe penale), përfshirë edhe për pozicionin e mbajtur nga ju sipas përcaktimit të paragrafit 5, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ndërkohë, më datë 25.07.2019, në Gjykatën e Lartë u krijua edhe një pozicion tjetër i lirë, për shkak të shkarkimit të një gjyqtari të kësaj Gjykate, gjyqtar edhe ky i ardhur nga radhët e juristëve të spikatur. Për shkak të krijimit të një pozicioni tjetër të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 11.09.2019, filloi një procedurë tjetër ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, duke plotësuar kështu numrin maksimal të këtyre procedurave që mund të hapte për këtë kategori prurjesh në këtë Gjykatë, referuar paragrafit 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit: "... Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur ...".

Mbas datës 25.07.2019, në Gjykatën e Lartë ju kishit mbetur gjyqtari i vetëm në detyrë.

Tre procedurat e para të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, u finalizuan më datë 11.03.2020, kur mbi propozimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Presidenti i Republikës dekretoi emërimin e tre gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të cilët, pas betimit më datë 13.03.2020, filluan ligjërisht ushtrimin e detyrës.

Ndërkohë, ju keni vazhduar të qëndroni në detyrë mbi arsytimin, sipas shpjegimeve tuaja, se jeni duke përmbushur detyrimin kushtetues në pritje të emërimit të pasardhësit, të cilin e përcaktoni pikërisht gjyqtarin e katërt që do të emërohet në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur.

Këshilli i Lartë Gjyqësor diskutoi në lidhje me atë nëse pasardhësi juaj është emëruar, duke konstatuar se ai tashmë është emëruar dhe ka filluar ushtrimin e detyrës.

Për këtë moment, referuar procedurave të organizuara për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, duke qenë se plotësimi i pozicionit të lirë që ju mbanit është përfshirë në tre procedurat e para, finalizimi i tyre përmes emërimit dhe fillimit të detyrës së tre gjyqtarëve të rinj, bën që pasardhësi juaj të konsiderohet i emëruar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se asnjë nga gjyqtarët e rinj të Gjykatës së Lartë nuk ju zëvendëson nominalisht, pasi secili prej tyre është emëruar për një mandat të plotë kushtetues 9-vjeçar. Por, nga ana tjetër, emërimi dhe fillimi i ushtrimit të detyrës nga tre gjyqtarët e rinj, në situatën e mospasjes edhe të një pozicioni tjetër të lirë të mëvonshëm në këtë Gjykatë që duhet të plotësohet nga radhët e juristëve të spikatur, pa asnjë mëdyshje ka çuar në përfundimin e detyrimit tuaj për qëndrimin në detyrë. Për këtë, megjithëse për rastit nuk

paraqet më rëndësi, në respektim të parimit të vazhdimësisë dhe funksionalitetit, në kushtet kur ju ishit gjyqtari i vetëm në detyrë në Gjykatën e Lartë, është i mundur interpretimi sipas të cilit gjyqtari i tretë i ri, i emëruar nga radhët e juristëve të spikatur, është ai që duhet të konsiderohet si pasardhësi juaj. Kjo sepse vazhdimi i qëndrimit tuaj në detyrë deri në emërimin e tij do të duhej për të mundësuar formimin e një trupi gjykues, pra për të mundësuar shqyrtimin nga Gjykata e Lartë të rekurseve ndaj vendimeve të gjykatave më të ulta, domethënë për të garantuar funksionimin minimal të saj.

Krijimi i mëvonshëm, pra pas fillimit të tre procedurave të para për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, edhe të një pozicioni tjetër të lirë, de facto dhe de jure pozicioni i fundit që mund të plotësohet nga kjo kategori, vlerësuar sipas parimit të funksionalitetit, është një rrethanë që mund të ngrejë diskutime për vazhdimin e qëndrimit tuaj në detyrë deri në emërimin e gjyqtarit që plotëson këtë pozicion.

Në fakt, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se prania e gjyqtarit të katërt në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në kushtet aktuale, pra kur në këtë Gjykatë nuk ka gjyqtarë të tjerë përveç tre gjyqtarëve të rinj të sipërpërmendur nga radhët e juristëve të spikatur, nuk sjell dhe as garanton funksionimin normal të kësaj Gjykate në lidhje me gjykimin e çështjeve në trupa gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë apo në Kolegje të Bashkuara. Po ashtu, prania e gjyqtarit të katërt nuk sjell dhe as garanton funksionim të shtuar të kësaj Gjykate në raport me praninë e vetëm tre gjyqtarëve.

Për këtë, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbajti në konsideratë interpretimin e bërë nga Gjykata Kushtetuese, në Vendimin nr.41/2012, të përcaktimit të pandryshuar të paragrafit 5, të nenit 125, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që bënte fjalë pikërisht për detyrimin e qëndrimit në detyrë të gjyqtarit kushtetues deri në emërimin e pasardhësit, rregull ky i njëjtë me atë sipas përcaktimit aktual për gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, bërë në paragrafin 5, të nenit 136, të Kushtetutës.

Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se “19. Legjitimiteti i kësaj Gjykate është një çështje e padiskutueshme, pasi ajo funksionon tërësisht brenda kriterëve dhe kushteve të përcaktuara nga Kushtetuta. Funksioni themelor i Gjykatës është garantimi i respektimit të Kushtetutës, interpretimi përfundimtar dhe sigurimi i epërsisë së saj në sistemin ligjor, nëpërmjet dhënies së drejtësisë kushtetuese. Në këtë këndvështrim, Gjykata rithekson edhe një herë se “rregulli i vazhdimësisë së qëndrimit në detyrë të gjyqtarit kushtetues është parashikuar për të garantuar, mbi të gjitha, funksionimin normal të Gjykatës në rast të krijimit të vendeve vakante, si pasojë e mosveprimit të ndonjërit prej organeve, të cilave Kushtetuta u njeh një rol të veçantë në këtë moment për zëvendësimin e gjyqtarëve të vjetër me gjyqtarë të rinj. Nisur edhe nga natyra kolegjiale e këtij organi të pavarur kushtetues, çdo mosveprim do të kishte pasoja në funksionimin e Gjykatës.”(Vendimi nr.24/2011 i Gjykatës Kushtetuese). / Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson se, ndërsa vazhdimi i qëndrimit në detyrë të gjyqtarëve kushtetues, sipas nenit 125/5 të Kushtetutës, përbën një detyrim për ta, kjo nuk do të thotë se Presidenti dhe Kuvendi mund të zgjasin tej çdo afati të arsyeshëm procedurat e zëvendësimit të tyre. Ata, bashkërisht, pa mbaruar ende mandati 9 vjeçar i gjyqtarëve, duhet të marrin masat e nevojshme si për përcaktimin e modaliteteve juridike procedurale, ashtu edhe për zëvendësimin e tyre brenda afateve procedurale të arsyeshme, me synim që të respektohet edhe detyrimi që buron nga neni 125/2 i Kushtetutës.

Në rrethanat si më lart, në kushtet kur ju vazhdoni të qëndroni në detyrë në Gjykatën e Lartë tashmë në vitin e shtatë pas mbarimit të mandatit, edhe në supozimin se pasardhësi juaj është

gjyqtari i fundit që do të emërohet nga radhët e juristëve të spikatur, Këshilli i Lartë Gjyqësor konstatoi se “afati i arsyeshëm” i qëndrimit tuaj në detyrë në pritje të pasardhësit që nënkupton paragrafi 5, i nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, tashmë është tejkaluar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se në situatën aktuale merr përparësi respektimi i parimeve të pavarësisë dhe paanësisë së gjykatës, në kuptimin e legjitimitetit të saj. Vazhdimësia dhe funksionaliteti i Gjykatës së Lartë, si proces kushtetues, janë në funksion të ruajtjes dhe forcimit të pavarësisë dhe paanshmërisë së saj. Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se “me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre” (Vendimi nr. 20/2009). Po ashtu, edhe Gjykata Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (GJEDNJ), në kuadër të paragrafit 1, të nenit 6, të Konventës Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ), është shprehur se “Për të përcaktuar nëse një gjykatë mund të konsiderohet e pavarur në kuptim të nenit 6§1, ndër të tjera, duhet mbajtur parasysh mënyra e emërimit të gjyqtarëve, kohëzgjatja në detyrë dhe ekzistenca e garancive kundër presionit të jashtëm dhe nëse trupa edhe në dukje paraqitet si e pavarur.” (Vendimi nr. 21722/11, Oleksan dr. Volkov kundër Ukrainës, parag.103). Ndërkohë, sipas paragrafit 1, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Kjo dispozitë, duke sanksionuar në mënyrë të qartë një kohëzgjatje të caktuar të mandatit kushtetues, përbën një nga faktorët që garantojnë pavarësinë e Gjykatës. Një mandat kushtetues i parashikuar specifikisht në kohëzgjatje, shmang rrezikun e influencës dhe presioneve politike ndaj gjyqtarit, duke qenë se këtij të fundit i garantohej kohëzgjatja dhe paprekshmëria e mandatit. Rregulli i vazhdimësisë së qëndrimit në detyrë të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë deri në emërimin e pasardhësit të tij, i parashikuar në paragrafin 5, të nenit 136, të Kushtetutës, garanton vazhdimësinë institucionale dhe mbi të gjitha funksionale të Gjykatës, pra garanton vijimin e dhënies së drejtësisë, proces thelbësor në një shtet të së drejtës. Kjo nuk është një e drejtë, por një detyrim kushtetues për gjyqtarët, në shërbim të misionit të dhënies së drejtësisë, që, ndërsa ata ushtrojnë këtë funksion, duhet të sigurojnë zbatimin e normave të shprehura në Kushtetutë, të ligjeve dhe të akteve të tjera ligjore, të garantojnë shtetin e së drejtës dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut (Vendimi nr. 11/2008, i Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, kjo dispozitë duhet të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me parimet themelore kushtetuese, referuar të cilave Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se, sikurse Gjykata Kushtetuese ka pranuar në vendimin e sipërpërmendur (Vendimin nr.41/2012), vazhdimi i qëndrimit në detyrë të gjyqtarëve me mandat të kufizuar (në rastin konkret të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë) nuk mund të zgjasë tej një afati të arsyeshëm. Për “afatin e arsyeshëm” Këshilli mbajti në konsideratë edhe shtjellimin e këtij koncepti nga pakica në atë vendim të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit “... vazhdimësia e gjyqtarit në detyrë duhet të kuptohet dhe zbatohet si një vazhdimësi brenda një kohëzgjatjeje të arsyeshme. Një periudhë e gjatë qëndrimi në detyrë pas mbarimit të mandatit, e cila mund të përbëjë konsumim të një pjese substanciale të mandatit të rregullt 9-vjeçar, megjithëse nuk është funksionalisht ekuivalente me një riemërim, juridikisht rrezikon t’i ngajë një riemërimi, ...”.

Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se kohëzgjatja e vazhdimit të qëndrimit në detyrë të një gjyqtari me mandat të kufizuar, pra të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, është çështje që ka të bëjë edhe me të drejtën e individit që çështja e tij të gjykohej jo vetëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, por edhe nga një gjykatë e krijuar me ligj, në kuptim të

paragrafit 1, të nenit 6, të KEDNJ-së. Në çështjen e sipërpërmendur (Oleksan dr. Volkov kundër Ukrainës) GJEDNJ-ja ka theksuar se “Shprehja “gjykatë e krijuar me ligj” lidhet jo vetëm me bazën ligjore për ekzistencën e vetë gjykatës, por edhe me përbërjen e trupit gjykues në çdo çështje (shih Buscarini kundër San Marino nr. 31657/96, Posokhov kundër Rosisë nr. 63486/00). Praktika e zgjatjes në heshtje të mandatit të gjyqtarit për një periudhë kohore të pacaktuar pas mbarimit të mandatit, deri në riemërimin e tyre, është konsideruar si shkelje e parimit “gjykatë e krijuar me ligj” (shih Gurov kundër Moldavisë, nr. 36455/02) - parag.151”. Mbi sa më lart, duke ardhur në rastin konkret, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi që, në supozimin se pasardhësi juaj duhet të konsiderohet gjyqtari i katërt dhe i fundit i Gjykatës së Lartë i ardhur nga radhët e juristëve të spikatur, vazhdimi i qëndrimit tuaj në detyrë në këtë Gjykatë do të ishte në shkelje të paragrafit 1, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Veç sa sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi të mbajë në konsideratë parimin e barazisë para ligjit në kuptimin e zbatimit të njëjtë të tij sa i përket standardit të atij që duhet të konsiderohet si pasardhës i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, si për atë të ardhur nga radhët e gjyqtarëve, ashtu dhe për atë të ardhur nga radhët e juristëve të spikatur. Kështu, në rast të pranimit se pasardhës është gjyqtari që emërohet i fundit sipas kategorisë respektive, atëherë, në supozimin që ju do të ishit emëruar nga radhët e gjyqtarëve, detyrimi i qëndrimit tuaj në detyrë do të përfundonte pas emërimit dhe fillimit të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit të katërmëdhjetë, duke mbajtur parasysh për këtë se një pozicion i kësaj Gjykate mbahet nga z.Medi Bici, mandati i të cilit është pezulluar për shkak të zgjedhjes anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nisur nga kjo, duke mbajtur parasysh faktin se aktualisht janë duke u zhvilluar procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, vetëm për gjashtë nga katërmëdhjetë pozicione të lira, si dhe kohëzgjatjen e këtyre procedurave që mund të shkojnë në disa muaj, mbetet të pranohet se kohëzgjatja e qëndrimit tuaj në detyrë tej mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë mund të shkojë edhe përtej shtatë viteve, domethënë gati sa vetë mandati kushtetues, ndërkohë që, si dhe më lart u përmend, paragrafi 1, i nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ndalon riemërimin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Sa sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi t’ju njoftojë për përfundimin e detyrimit tuaj për qëndrimin në detyrë në Gjykatën e Lartë deri në emërimin e pasardhësit, sipas paragrafit 5, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pasi pasardhësi juaj tashmë është emëruar.

Nisur nga kjo, në kushtet kur ligji, nenet 61 dhe 62, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ju njohin të drejtën për t’u caktuar në nivel apeli, Këshilli i Lartë Gjyqësor ju fton të shpreheni nëse do ta ushtroni këtë të drejtë, me qëllim për të ndjekur procedurat përkatëse për realizimin e saj. Këshilli i Lartë Gjyqësor ju fton që qëndrimin tuaj ta parashtrooni me shkrim brenda një jave.

K YETARE

NA

